Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01-62
Datë 16.06.2016

Në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 mbi Kualifikimet Kombëtare të datës 7 nëntor 2008 dhe Udhëzimit Administrativ nr. 35/2014 të datës 20. 11. 2014 mbi Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me nenet 4, 7, 10, 11, 16 dhe 17, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve me datë 26.05.2016 nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Për akreditimin e "N. SH. Kas" në Ferizaj, se bashku me dy nën qendra në Prishtinë dhe Gjilan, për periudhën 3 vjeçare, prej 26. 05. 2016 deri 26. 05. 2019 për këto kualifikime të aprovuara:

   1.1. Parukier/e, niveli i KKK (III).

   1.2. Validimi i kualifikimit dhe akreditimi i institucioni/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim:

- Adaptimi i plan programit, në aspektin përmbajtjesor e në veçanti fondi i orëve për secilin modul.
- Përputhja e orëve mësimore të paraqitura për akreditim me atë që zhvillon realisht.
- Të hartohet katalogu me pyetje dhe detyra për provimin përfundimtar. Vlerësimi të bëhet me pikë dhe jo nota.
- Kualifikim shtesë i trajnerëve dhe asistenteve për të zhvilluar modulet aftësuese në kuadër të qendrës profesionale KAS.
- Të organizohet vlerësimi përfundimtar i kandidatëve, mundësisht me vlerësues të jashtëm (përfshirë në panel edhe një frizer/e të kualifikuar nga sektori privat), që nënkupton edhe

përgatitjen e formatit të certifikatës ku të përfshihen kompetencat profesionale të përfituara të kandidatit.

- Të hartohet modeli i testit përfundimtar TEORIKO-PRAKTIE ku të përfshihen pyetje me alternativa-zhvillim-dhe model real.
- Vlerësimi të bëhet me Pikë dhe jo me Notë.
- Trajnerët dhe kandidatët të kenë uniforma pune me logon e qendrës.
- Pajisje e pjesërishme e kabinetit për punë praktike me karrige profesionale.

(Afati kohor: 15. 07. 2016)

2. Arsyetim

Në bazë të kërkesës së institucionit/ofruesit me datë: 26.05.2016, Këshilli Drejtues i AKK-së merr këtë vendim bazuar në rekomandimet të dala nga Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Validimin e kualifikimit, Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Akreditimin e Institucionit i cili ofron dhe/ose vlerëson dhe lëshon kualifikime të aprovuara dhe këto rekomandime janë të mbështetura në fakte dhe dokumente si në vijim:

- Aplikacioni për Validim të Kualifikimit/Modulit;
- Aplikacioni për Akreditim si Institucionit Ofrues dhe/ose Vlerësues dhe Lëshues të Kualifikimit;
- Raporti i Vetë-vlerësimit;
- Vizita në institucionin/ofruesin aplikues, dhe
- Dokumente tjera shtesë.

2.1. Pala e pakënaqur me vendimin, ka drejtë ankese në organet e shkallës së dytë. Ankesa bëhet përmes organit të shkallës së parë.

3. Kushtet e parashtruara për aprovim dhe akreditim duhet të përmbushen në afatin e caktuar nga AKK, në rastin kur institucioni/ofruesi nuk i përmbushë këto kritere, AKK ka të drejtë tërheqjen e aprovimin dhe akreditimit.

4. Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit të tij.

5. Vendimi i dërgohet:

- "N.SH. Kas" në Ferizaj; dhe
- AKK.

Kryetari i KD së AKK-së
Osman Buleshkaj